



**Doracak për pëdorues**

**NUMRI  
STANDARD  
NDËRKOMBËTAR I  
MUZIKËS**

**ISMN**

**Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës  
Doracak për përdorues**

**Përktheu**

Besim J. Kokollari

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe  
Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës

Prishtinë, 2007

**Titulli i origjinalit:**  
ISMN Users' Manual  
International Standard Music Number

© 2007 Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

**Botues:**  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe  
Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës

**Përktheu:**  
Besim J. Kokollari

**Redaktor:**  
Edona Munishi –Kokollari  
Fazli Gajraku

Prishtinë, 2007

## Përmbajtja

Hyrje .....	4
1. Historiku .....	5
2. Si është i ndërtuar Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës .....	5
2.1. Elementet .....	6
2.1.1. Elementi dallues.....	6
2.1.2. Identifikuesi i botuesit .....	6
2.1.3. Identifikuesi i njësisë (kopjes).....	6
2.1.4. Shifra e kontrollit .....	7
2.2. Numri i shifrave në secilin element dhe si të dallohen ato në një ISMN .....	7
3. Fushëveprimi i ISMN-së.....	8
4. Parimet dhe procedurat të cilat duhet t'i përcjellin botuesit gjatë numërimit të botimeve të tyre.....	9
4.1. Caktimi i numrit identifikues të botuesit .....	9
4.2. Këshillë për t'u ndjekur – autoriteti.....	9
4.3. Përgjegjësia .....	9
4.4. Regjistri.....	10
4.5. ISMN-ja si numër për numërimin e njësisë të botuesit të cilat i ruan në depo apo si numër për numërimin e secilit version të botimeve .....	10
5. Botuesit të cilët nuk dëshirojnë të përfshihen në ISMN .....	10
6. Përdorimi i ISMN-së.....	10
6.1. Faksimilet e shtypura dhe botimet në mikroformë.....	12
6.2. Materialet e lidhura në forma të ndryshme .....	12
6.3. Formatet e ndryshme .....	13
6.3.1. Partiturat dhe pjesët .....	13
6.3.3. Pjesët të cilat i gjejnë të ndara.....	14
6.3.4. Pjesët të cilat i gjejnë edhe të ndara edhe komplet.....	14
6.3.5. Pjesët të cilat nuk i gjejnë të ndara, por vetëm komplet .....	14
6.3.6. Disa prej pjesëve që dalin të ndara, e disa vetëm si pjesë të kompletit .....	14
6.3.7. Kopje në disa paketime .....	15
6.4. Versione të ndryshme .....	15
6.5. Botimet shumëvëllimëshe .....	15
6.6. Botimet me materiale plotësuese .....	16
6.7. Antologjitë dhe ekstraktet .....	16
6.8. Materialet e botuara më herët .....	16
6.9. Të drejtat e blera nga botuesit e tjerë.....	16
6.10. Botimet e përbashkëta.....	16
6.11. Muzika e shitur ose e shpërndarë përmes agjentëve .....	17
6.12. Botuesit me më shumë se një vend të botimit .....	17
6.13. ISMN të mos përdoret dy herë në kurrfarë rrethane .....	17
7. Shtypja dhe reklamimi i ISMN-së .....	17
7.1. Shtypja e ISMN-së në veprat muzikore .....	18
7.1.1. Vendi ku duhet të shtypet ISMN-ja.....	18
7.1.2. Shtypja e të gjitha ISMN-ve të cilat i takojnë një botimi .....	18
7.2. Shtypja e ISMN-së në kod të lexueshëm prej mjeteve kompjuterike .....	19

7. 3. Vënia e barkodit me 13 shifra. Udhëzime për prodhuesit e etiketave të barkodeve .....	20
7. 4. Publikimi i ISMN-së .....	20
8. Administrimi i sistemit të ISMN-së .....	21
8. 1. Administrimi ndërkombëtar .....	21
8. 2. Administrimi kombëtar apo rajonal.....	22
9. ISMN-ja dhe numrat e tjerë standard ndërkombëtar.....	23
9. 1 ISBN-ja.....	23
9.2. ISSN-ja .....	24
9.3. ISRC .....	25

## Hyrje

Pas një periudhe të caktuar që kur versioni paraprak i Doracakut për përdorues i ISMN-së ka qenë në qarkullim, ky është botimi i parë i plotë i interpretimit të standardit ISO 10957. Pjesën më të madhe të këtij botimi e ka përpiluar fillimisht Lenore Coral (Biblioteka Universitare Cornell, Itakë) dhe Ander Lonn (Biblioteka Akademike e Muzikës, Stokholm). Ky botim ka përfituar nga sugjerimet e vlefshme të Jane Thacker (Otavë).

*Doracaku i parë i ISMN-së* ishte botuar në gjermanisht në gusht të vitit 1994, dhe paraqet një provë që botuesit në hapësirën gjermano-folëse janë shumë të interesuar në ISMN.

Paragrafët, sa i përket barkodit, nuk janë shtjelluar këtu për arsye se për këtë çështje janë duke u bërë diskutime dhe negociata më organizatën ndërkombëtare EAN. Përndryshe, ky doracak është i plotë. Për t'i përmbushur nevojat e domosdoshme anekënd botës, ky botim del në formën e parë preliminare. Botimi përfundimtar është caktuar të bëhet në vjeshtë të vitit 1995.

Hartmut Walravens

Berlin, shkurt 1995

### **Botimi i tretë – hyrje**

*Doracaku për përdorues i ISMN-së* ka dalë përsëri jashtë botimit. Botimi i tretë tash paraqet një mundësi të mirë për të bërë disa shënime shtesë.

Në ndërkohë sistemi i ISMN-së ka arritur të krijojë njëzet agjenci, ndërsa botimi i dytë i *Udhëzuesit të ISMN-së për botuesit ndërkombëtar të muzikës* paraqet një arritje tjetër. Tregu i muzikës tashmë i ka dy botime në CD-ROM të *Materialeve muzikore në shtyp e sipër* (në Gjermani dhe Britani të Madhe), si dhe një bazë e të dhënave është në dispozicion në Internet për të bërë porosi po përmes Internetit - kjo tregon për pranimin e ISMN-së.

Hartmut Walravens

Berlin, korrik 1998

## 1. Historiku

Meqë ISBN-ja u bë një mjet i përdorur gjerësisht nga tregu i librit, botuesit e muzikës kërkuan një numër standard të ngjashëm me ISBN-në për muzikën e shtypur. Një element i vonshëm gjatë diskutimeve ishin kundërthëniet nëse një numër i thjeshtë identifikimi do të mjaftonte apo do të nevojitet ndonjë kod bibliografik, i cili do të paraqiste, për shembull, lidhjen ndërmjet partiturës dhe pjesëve të veçanta.

Në kohën kur Shoqata Ndërkombëtare e Bibliotekarëve të Muzikës, Arkivave dhe Qendrave të Dokumentimit (International Association of Music Librarians, Archives and Documentation Centres - IAML), të Degës së Britanisë së Madhe, iu drejtua Agjencisë ndërkombëtare të ISBN-së me një propozim prej një numri dhjetëshifror pa kodet bibliografikë. Kjo skemë u botua në revistën *ISBN Review* dhe gjeti mbështetje të menjëhershme nga mbarë bota. ISO / TC 46 e pranoi zyrtarisht propozimin si një projekt pune, dhe pastaj u arrit një marrëveshje mes botuesve dhe specialistëve evropianë dhe amerikanë në takimin e ekspertëve evropianë dhe amerikano-veriorë në Ottawa, pas disa diskutimeve intensive. Argumenti kryesor për ta shpërfillur idenë e mëparshme prej një numri 13-shifror kishte të bënte me përvojën e gjatë me ISBN-në, dhe opsioni i përfshirjes së një numri dhjetëshifror në sistemin 13-shifror të barkodit ndërkombëtar, zuri vend, duke e zgjeruar thjesht sistemin e ISBN-së. Projekt-propozimi i ISMN-së u përpunua nga grupi punues i ISO-s brenda një kohe të shkurtër dhe doli zyrtarisht kah fundi i vitit 1993, standard i cili u botua në Gjenevë.

ISMN-ja mund të shihet si nënstrukturë e ISBN-së. Me qëllim të parandalimit të pështjellimit mes dy numrave standard, dhjetë-shifror, në skemën e ISMN-së u futën disa ndryshime të vogla, të cilat e dallonin nga sistemi i ISBN-së:

- shifra e parë është konstante “M”;
- nuk ka asnjë grup-numër, duke u bazuar në faktin se muzika është ndërkombëtare;
- shifra e kontrollit është llogaritur në bazë të modulit 10.

Përderisa të dy numrat standard mund të integrohen në një sistem barkodi 13-shifror, ata përdoren zakonisht pa ndonjë prefiks të barkodit, p.sh. për porositje, identifikim bibliografik dhe për qëllime të përpunimit ndërkombëtar. Për këtë arsye, këto ndryshime janë të nevojshme me qëllim të largimit të pështjellimit.

ISMN-ja ofron lehtësi të përdorimit të plotë nga botuesit dhe tregtarët e materialeve muzikore si dhe nga bibliotekat e muzikës.

## 2. Si është i ndërtuar Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës

Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës (ISMN) përbëhet prej shkronjës “M”, i pasuar nga nëntë shifra të tjera. Kudo që shkruhet apo shtypet, numri paraprihet me shkronjat “ISMN”.

*Shënim.* Në vendet në të cilat nuk përdoret alfabeti latin, mund të përdoret shkurtesa në gjuhën e atij vendi, krahas shkronjave latine “ISMN”.

## **2.1. Elementet**

ISMN-ja përbëhet prej katër elementeve, dy prej të cilave janë gjatësi variabël. Me rastin e shtypjes së ISMN-së, secili element ndahet me një vizë lidhëse apo hapësirë. Të katër elementet janë si në vijim:

### **2.1.1. Elementi dallues**

Shkronja “M” e dallon ISMN-në prej ISBN-së.

### **2.1.2. Identifikuesi i botuesit**

Ky element e identifikon një botues të veçantë.

Identifikuesi i botuesit e përcakton botuesin e një materiali muzikor. Botuesve me prodhim të madh të materialeve muzikore u caktohet identifikues më i shkurtër i botuesit; botuesve me prodhim më të vogël u caktohet identifikues më i gjatë i botuesit. (Për shpërndarjen e identifikuesve të botuesit sipas gjatësisë së tyre variabile shih kapitullin 2.2).

### **2.1.3. Identifikuesi i njësisë (kopjes)**

Ky element e identifikon botimin e një vepre dhe të njëjtit të ndryshme brenda saj, p. sh. një partiturë të plotë, partitura në miniaturë, komplete të pjesëve të instrumenteve me frymë, pjesë të obosë, etj. Një njësi, sipas standardit, është pjesë përbërëse e një botimi në fushën muzikore, e cila mund të shitet, të blihet dhe t’i qasemi në mënyrë të veçantë prej pjesës kryesore të cilës i përket.

Identifikuesi i njësisë i caktohet një njësie të veçantë nga vetë botuesi brenda numrave të cilët më parë iu kanë caktuar atij. Gjatësia e identifikuesit të njësisë varet prej gjatësisë së identifikuesit të botuesit.

Botuesit zakonisht e caktojnë vetë identifikuesin e njëjtit (shih po ashtu kapitullin 5 për botuesit, që nuk marrin pjesë në sistem). Botuesit të cilët i caktojnë vetë numrat identifikues, mund t’i përdorin ata, t’i identifikojnë njësitë brenda shtëpisë botuese gjatë tërë periudhës së planifikimit, t’i identifikojnë materialet të cilat i botojnë për t’i dhënë me qira, etj.



### 2.1.4. Shifra e kontrollit

Kjo është një shifër e vetme në fund të ISMN-së, e cila e siguron vërtetimin në mënyrë automatike se a është e saktë ose jo ISMN-ja. Këtë proces e kryen kompjuteri.

Shifra e kontrollit llogaritet në bazë të modulit 10 dhe me një masë shumëzimi me vlerë 3, ndërsa vlera 1 futet nga e majta në të djathtë, duke filluar me shkronjë “M” si prefiks.

Shkronja “M” numërohet si 3.

Kjo do të thotë se secila prej nëntë shifrave të para të ISMN-së – d.m.th., duke e lënë jashtë shifrën e kontrollit - shumëzohet me vlerën 3 (e para) dhe 1 (e dyta, e kështu më radhë) të cilat radhiten nga e majta në të djathtë. Shuma e përfituar, si dhe shifra e kontrollit duhet të jenë të pjesëtueshme me 10 si dhe të mos përfitohet mbetje.

*Shembull:*

		Identifikimi i botuesit	Identifikimi i njësisë							
ISMN	M	3	4	5	2	4	6	8	0	5
Masa	3	1	3	1	3	1	3	1	3	—
Rezultati	9	3	12	5	6	4	18	8	0	= 65

Gjithsej:  $65 + 5$  (shifra e kontrollit) = 70

Pasi që numri 70 mund të pjesëtohet me 10, ku mbetja është zero, atëherë Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës M-3452-4680-5 është numër valid.

### 2.2. Numri i shifrave në secilin element dhe si të dallohen ato në një ISMN

Numri i shifrave në elementet identifikuese 2 dhe 3 është variabël, meqenëse numri i përgjithshëm i shifrave brenda këtyre elementeve është gjithmonë 8. Këto 8 shifra, së bashku me shifrën e kontrollit dhe të paraprirë me shkronjën “M”, përbëjnë numrin e përgjithshëm të shifrave në një ISMN - që është 10.

Botuesve, të cilët parashohin të kenë një veprimtari të madhe botuese, u caktohen numrat prej 3 ose 4 shifrash, ndërsa botuesve me veprimtari të vogël botuese u caktohen numra prej 5, 6, dhe 7 shifrash.

Për shkak të lehtësisë së leximit, të katër elementet e ISMN-së ndahen mes vete me hapësira apo vizë lidhëse. Megjithatë, kompjuteri nuk i ruan këto hapësira apo viza

lidhëse, por ai e njeh strukturën e brendshme të ISMN-së, duke i përputhur tre apo katër numrat e parë me serinë e identifikuesve të botuesit.

Tabela e mëposhtme paraqet një mundësi të rregullimit të identifikuesve të botuesit:

Identifikuesi i botuesit	Shuma e numrat në dispozicion për identifikimin e njësisë
000 - 099	100000
1000 - 3999	10000
40000 - 69999	1000
700000 - 899999	100
9000000 - 9999999	10

Duke e shikuar një njësi të botuar me numrin M 299102349, mund të shihet se nuk mund të ketë botues me numër identifikues 299, por me numër identifikues 2991. Pa marrë parasysh se janë hequr hapësirat mes të tri elementeve në këtë numër, radhitja e identifikuesve, që në shikim të parë, tregon se elementi identifikues i botuesit është numri 2991.

### 3. Fushëveprimi i ISMN-së

ISMN-ja përdoret për të identifikuar muzikën e shtypur, pa marrë parasysh se a shitet, a merret me qira, a është falas apo përdoret vetëm për qëllim të mbrojtjes së të drejtës autoriale.

ISMN-ja nuk është krijuar për incizimet zanore dhe video (përveç në rastet e rralla të cekura më poshtë): përderisa nuk ka ndonjë sistem ndërkombëtar të identifikimit të këtyre njësive, incizimet zanore identifikohen veç e veç me Kodin Standard Ndërkombëtar të Incizimeve (ISRC – International Standard Recording Code). ISMN-ja nuk përdoret për librat që trajtojnë tema muzikore, por ato e marrin Numrin Standard Ndërkombëtar të Librit (ISBN). Shih kapitullin 9 për zbatimin e llojeve të ndryshme të numrave standardë.

Secila pjesë përbërëse e një botimi që shitet apo gjendet në treg, ose edhe për ndonjë qëllim tjetër, si e ndarë, duhet ta ketë ISMN-në e vet.

Botimet që marrin ISMN-në, janë:

- Partiturat;
- Partiturat miniaturë (për studime);
- Partiturat vokale;
- Kompletet e pjesëve;
- Pjesët individuale;
- Pop folio-t;
- Antologjitë e partiturave;

- Materialet në medime të tjera, të cilat janë pjesë integrale të një vepre muzikore (p.sh. një shirit i incizuar – kasetë, që është një prej ‘pjesëve’ të një kompozicioni);
- Tekstet e këngëve ose lirikat e botuara me vepra muzikore (nëse janë në pjesë individuale);
- Shpjegimet e komentet, të botuara me vepra muzikore (si dhe ato në pjesë individuale);
- Librat e këngëve (opcionale) (shih kapitullin 9.1);
- Veprat muzikore në mikroformë;
- Veprat muzikore braile;
- Veprat muzikore elektronike.

Botime që nuk marrin ISMN, janë:

- Librat që trajtojnë tema muzikore;
- Incizimet zanore a videot, që qëndrojnë të mëvetësishme (përfshirë edhe incizimet që mund të gjenden në materiale të bëra për kompjuter);
- Periodikët dhe serialet, si tërësi - për dallim nga vëllimet individuale në seri (shih kapitullin 9.2).

## **4. Parimet dhe procedurat të cilat duhet t’i përcjellin botuesit gjatë numërimit të botimeve të tyre**

### **4.1. Caktimi i numrit identifikues të botuesit**

Një botuesi do t’i caktohet identifikuesi i botuesit nga agjencia kombëtare apo rajonale, e cila do të vendosë për serinë e identifikuesve të njësisë që do të jenë në dispozicion për atë botues. Numri i identifikuesve të njësisë do të varet nga gjatësia e identifikuesit të botuesit. Botuesi duhet t’i japë agjencisë sa më shumë informacion që të jetë e mundur për (1) listën e botimeve të cilat i ka për botim, dhe për programet (2) e tashme dhe (3) të ardhme, me qëllim që t’i caktohet një identifikues i përshtatshëm botimi. Për botuesit me më shumë se një vend të botimit, shih kapitullin 6.12.

### **4.2. Këshillë për t’u ndjekur – autoriteti**

Botuesit janë përgjegjës për vënien e identifikuesit të njësisë për secilën kopje të cilën e botojnë. Këshillohet që ISMN-ja t’i caktohet njësisë atëherë kur dihet koha e botimit të njësisë në fjalë.

### **4.3. Përgjegjësia**

Botuesit duhet ta caktojnë një person i cili do ta ketë përgjegjësi të merret me vënien e ISMN-së në njësitë që i botojnë, dhe i cili do t’i zbatojë rregullat lidhur me këtë standard.

#### **4.4. Regjistri**

Secili botues duhet ta mbajë një regjistër të ISMN-ve të cilat i ka vënë. Regjistri duhet të përfshijë ISMN-në, autorin, titullin dhe formatin (në rastet kur ka nevojë).

#### **4.5. ISMN-ja si numër për numërimin e njësive të botuesit të cilat i ruan në depo apo si numër për numërimin e secilit version të botimeve**

Botuesit mund ta përshtatin ISMN-në si numër për numërimin e njësive, të cilat i mbajnë në depo apo si numër për numërimin e secilit version të botimit. Botuesit, të cilët mendojnë t'i mbajnë numrat e mëparshëm të njësive të botimeve apo të numrave të mëparshëm të versioneve të ndryshme, krahas ISMN-së, do t'u nevojitet të mbajnë dallimin mes sistemeve të ndryshme të numërimit.

#### **5. Botuesit të cilët nuk dëshirojnë të përfshihen në ISMN**

Nëse për shkak të dëshirës së tyre apo për ndonjë arsye tjetër, ndonjë botues nuk e pranon përgjegjësinë për t'u vënë botimeve ISMN-në, atëherë agjencisë kombëtare të ISMN-së i mbeten dy mundësi:

- a. Agjencia kombëtare mund të rezervojë një seri numrash për botues të ndryshëm dhe t'u vënë ISMN-në të gjithë titujve brenda asaj serie pa e marrë parasysh botuesin. Në një rast të tillë ISMN-ja nuk do ta identifikojë botuesin.

Këshillohet që kjo procedurë duhet të rezervohet për botuesit të cilët e botojnë ndonjë titull aty-këtu dhe të cilët nuk duket se do ta marrin ndonjëherë përgjegjësinë e të vënit të numrit të ISMN-së në botimet e tyre.

- b. Agjencia kombëtare, e cila është përgjegjëse për caktimin e identifikuesit të botuesit, mund të marrë përgjegjësi edhe të vënies së identifikuesve të njësive (që ka të bëjë me një identifikues të një botuesi të caktuar), të cilat dalin në botim të një botuesi të caktuar. Agjencia duhet ta informojë botuesin para vendosjes së numrit të ISMN-së për një botim të caktuar.

Në raste të tilla, nëse botuesi pajtohet të veprojë ashtu, ISMN-ja mund të shtypet në kopjen e materialit. Supozohet se një botues i tillë së fundi do të marrë përgjegjësinë e plotë të vënies së ISMN-ve në botimet e tij.

#### **6. Përdorimi i ISMN-së**

Secilit ribotim të një njësie duhet t'i vihet ISMN e veçantë. E veçanërisht:

- Një ndryshim në përmbajtjen muzikore apo letrare të veprës - përveç kur ka përmirësime të vogla - kërkon ISMN të re.

- Kur teksti letrar, që pjesë e pandashme e një vepre muzikore, ka ndryshuar nga botimi i mëparshëm, atëherë njësisë duhet t'i vihet ISMN-ja e re.
- Kur një përkthim i një teksti letrar është shtuar, hequr apo ndryshuar, atëherë ISMN-ja e re duhet t'i vihet, edhe pse teksti apo muzika nuk ka ndryshuar.
- Kur madhësia fizike e një njësie ka ndryshuar dukshëm me qëllim të prodhimit të një ribotimi të ri të plotë të një partiture miniaturë, atëherë ISMN-ja e re duhet t'i vihet këtij botimi.

Një botim i pandryshuar i njësisë së njëjtë në po të njëjtin format dhe i botuar nga po i njëjti botues, nuk duhet të marrë ISMN të re (përveç nëse ka ndryshime në lidhjen e njësisë e cila përshkruhet në kapitullin 6.2). Po ashtu, një riprodhim i po të njëjtës njësi i bërë për shkak të kërkesës, nuk duhet të marrë ISMN të re edhe nëse data e re e riprodhimit paraqitet në njësi.

Ndryshimet në çmim nuk kërkojnë që një kopje t'i vihet ISMN e re.

### **6. 1. Faksimilet e shtypura dhe botimet në mikroformë**

Faksimiles së ribotuar nga një botues tjetër duhet t'i vihet ISMN e re.

Po ashtu edhe një botimi në mikroformë duhet t'i vihet gjithmonë një ISMN e re.

### **6.2. Materialet e lidhura në forma të ndryshme**

ISMN e veçantë u vihet secilit botim të lidhur në formë të ndryshme të të njëjtit titull, edhe pse përmbajtja është krejtësisht e njëjtë. Për shembull, një botim në kopertina të forta, merr një ISMN tjetër dhe, një botim në kopertina të buta, merr një ISMN tjetër:

Partiturë e plotë (me lidhje të butë)	
Partiturë e plotë me komente (së bashku)	
Partiturë vokale (me lidhje të butë)	
Partiturë vokale (me kopertina të mbështjella me pëlhurë)	= 4 ISMN-të
Partiturë me valle (me lidhje të butë)	
Partiturë me valle (pa kopertina)	= 2 ISMN-të

Ndryshimi i dizajnit të kopertinës, e ndërsa përmbajtja e njësisë nuk ndryshon, apo ndryshimi i ngjyrave apo ndryshime të tjera të vogla mes një lidhje të një botimi të

caktuar dhe të botimit tjetër pasues, nuk përbëjnë ndryshim të lidhjes, dhe si rrjedhojë nuk duhet të marrin ISMN të re.

### 6.3. *Formatet e ndryshme*

Secila pjesë e një botimi, e cila mund të shitet apo sigurohet si e tillë, duhet të ketë ISMN-në e vet. Këshillohet që e tërë lista e ISMN-ve, që u janë vënë pjesëve përbërëse të një botimi, të shtypen në njëërën apo më shumë njësi (shih kapitullin 7.1)

#### 6.3.1. *Partiturat dhe pjesët*

Në një botim, që përbëhet nga partitura dhe pjesë, partiturë e plotë, një kompletë pjesësh të cilat përbëjnë një tërësi, si dhe secila pjesë veç e veç (nëse janë të ndara) duhet të ketë ISMN-në e vet:

Partiturë e plotë	= 4 ISMN-të
Partiturë vokale	
Komplet i pjesëve të një kori	
Pjesë individuale të korit	

#### 6.3.2. *Partiturat, të cilat i gjejmë si pjesë të një kompleti*

Kur një partiturë mund të gjendet në treg vetëm si një njësi/kopje brenda një kompleti dhe jo si kopje individuale, atëherë ISMN-ja duhet t'i vihet kompletit.

Vetëm nëse parashihet se në një të ardhme këto kopje të kompletit do të gjenden në treg si njësi/kopje të veçanta, atëherë secila njësi duhet ta ketë ISMN-në e vet unike:

Partiturë për piano dhe dy pjesë të cilat gjenden si një komplet	= 1 ISMN
--	----------

Partitura për piano dhe dy pjesë të tjera do të marrin secila prej tyre ISMN-në e njëjtë.

Kur partitura do të jetë edhe si njësi e veçantë edhe si pjesë e një kompleti, atëherë duhet t'i vihet ISMN-ja e vet.

Partiturë	= 2 ISMN-të
Partiturë dhe pjesët e një kompleti	

Partitura do të marrë një ISMN, ndërsa kompleti do të marrë një ISMN të dytë.

### 6.3.3. Pjesët të cilat i gjejmë të ndara

ISMN-ja duhet t'i vihet secilës pjesë të shtypur e cila është në dispozicion kopje më vete:

Violinë I pjesë	= 4 ISMN-të
Violinë II pjesë	
Pjesë viole	
Pjesë violonçeli	

### 6.3.4. Pjesët të cilat i gjejmë edhe të ndara edhe komplet

Kur pjesët e shtypura gjenden edhe si komplet e po ashtu edhe si kopje të ndara, atëherë kompletit duhet t'i vihet ISMN-ja e vet, si dhe secila pjesë e shtypur mund të marrë ISMN-në e vet, pasi secila syresh është kopje më vete:

Pjesë violine	= 4 ISMN-të
Pjesë viole	
Pjesë violonçeli	
Komplet pjesësh	

### 6.3.5. Pjesët të cilat nuk i gjejmë të ndara, por vetëm komplet

Kur pjesë instrumentale apo vokale nuk dalin nga botimi si pjesë të ndara, por vetëm si pjesë të një kompleti, atëherë një ISMN duhet t'i vihet kompletit, ndërsa secila pjesë e shtypur ndaras brenda kompletit do të marrë ISMN të njëjtë, e cila iu ka vënë kompletit:

Partiturë	= 2 ISMN-të
Komplet pjesësh	

Partitura do ta marrë ISMN-në e vet; secila pjesë veç e veç do të marrë ISMN, e cila iu ka vënë kompletit.

*Shënim:* pjesët e veçanta, të cilat dalin si pjesë e një kompleti, do të marrin ISMN-në e vet vetëm nëse ato dalin në treg si kopje më vete.

### 6.3.6. Disa prej pjesëve që dalin të ndara, e disa vetëm si pjesë të kompletit

Kur disa prej pjesëve që kanë dalë nga shtypi si pjesë më vete e disa prej atyre pjesëve kanë dalë si pjesë e kompletit, atëherë secila prej pjesëve që kanë dalë më vete do të marrë ISMN-në e vet individuale; ndërsa, të gjitha pjesët e tjera marrin ISMN, që i është caktuar atij kompletit të cilit i takojnë:

Partiturë	= 6 ISMN-të
Komplet pjesësh	
Komplet instrumentesh pa tela	
Pjesë - violinë I	
Pjesë - violinë II	
Pjesë violonçeli/basi	

### 6.3.7 Kopje në disa paketime

Kur një kopje individuale e cila ka dalë nga shtypi si e veçantë dhe mund të gjendet në treg si e tillë, mirëpo mund të gjendet edhe në një paket i cili përmban kopje të shumta të të njëjtës njësi, atëherë paketi duhet të marrë ISMN-në e vet unike:

Fletëpalosje	= 2 ISMN-të
Paket fletëpalosjesh (komplet prej 100 kopjesh)	

### 6.4. Versione të ndryshme

Nëse botuesi e boton një titull në më shumë se një version, secili version duhet të ketë ISMN-në e vet unike:

Piano solo	= 3 ISMN-të
Piano - version duet	
Organ solo - aranzhim	
Me zë të lartë	= 2 ISMN-të
Me zë të mesëm	

### 6.5. Botimet shumëvëllimëshe

Një ISMN duhet t'i vihet të tërë kompletit të vëllimeve të një botimi në shumë vëllime, si dhe secilit vëllim veç e veç të kompletit. (Shih kapitullin 9.2):

Vëllimi 1	= 4 ISMN-të
Vëllimi 2	
Vëllimi 3	

Partiturë dhe komente kritike (komplet)	= 3 ISMN-të
Partiturë	
Komente kritike (të botuara ndaras)	



*Shënim:* nëse njëri prej vëllimeve është i shtypur vetëm në tekst, atëherë mund t'i vihet edhe ISBN-ja.

## **6.6. Botimet me materiale plotësuese**

Kur një vepër muzikore përfshin edhe materiale plotësuese, të tilla si tekst këngësh apo lirika, komente, apo diçka të tillë, dhe se kopjet shiten vetëm si pjesë kompleti, njësia plotësuese do të marrë ISMN-në e njëjtësi të vëllimit që e shoqëron:

Partiturë	= 1 ISMN
Komente kritike (që nuk ka dalë si e veçantë)	
Pjesë zëri dhe testature	= 1 ISMN
Fletë lirike (që nuk ka dalë si e veçantë)	

Nëse materialet plotësuese shiten ndaras e po ashtu edhe së bashku, atëherë botimi duhet të trajtohet si botim shumëvëllimësh sipas kapitullit 6.5.

## **6.7. Antologjitë dhe ekstraktet**

Antologjitë dhe ekstraktet duhet të kenë numrat e tyre unik të ISMN-së, pa marrë parasysh nëse njësitë në një antologji apo në veprën më të madhe kanë qenë më parë të botuara ose jo, apo që një kohë të gjatë kanë dalë prej shtypit. Vënia e ISMN-së të një kopje individuale në kontekstin e mëparshëm mund të shtypet në kopje, për shembull, në fund të faqes së parë të secilës pjesë muzikore. ISMN-të e tilla duhet të dallohen qartas prej ISMN-së së botimit të ri.

## **6.8. Materialet e botuara më herët**

Botuesit luten që t'u vënë numra materialeve të botuara më herët dhe t'i botojnë ISMN-të në katalogët e tyre. Ata duhet po ashtu ta shtypin ISMN-në në ribotimin e parë të një kopje nga materialet e botuara më herët.

## **6.9. Të drejtat e blera nga botuesit e tjerë**

Kur një botues, përfshirë edhe një agjent, i cili ka të drejtën vetëm të shitjes, i ka blerë të drejtat për një vepër muzikore nga një botues tjetër dhe e boton atë vepër nën vulën e shtëpisë së tij botuese, atëherë botimit duhet t'i vihet një ISMN e re nga botuesi i ri. Nëse disa botues i kanë blerë të drejtat, secili për territorin e vet, atëherë secili prej tyre do ta vërë ISMN-në e tyre.

## **6.10. Botimet e përbashkëta**

Kur një botim del si botim i përbashkët me një botues tjetër, atëherë botimit mund t'i vihen ISMN-të nga secili botues pjesëmarrës. ISMN-të nga të gjithë botuesit e përmendur në veprën e botuar duhet të shtypen në të për shkak të qartësisë në identifikim.

### **6. 11. Muzika e shitur ose e shpërndarë përmes agjentëve**

Sipas parimeve të ISMN-së, një version i caktuar, i botuar nga një botues i caktuar, e merr vetëm një ISMN. ISMN-ja duhet të mbetet aty pa marrë parasysh se ku apo kush e shpërndan ose e shet atë material muzikor. Vetëm në rrethana të veçanta, një numër të ISMN-së, mund të vihet nga shpërndarësi:

- a. kur një botimi të muzikës, i importuar nga një shpërndarës (distributor) ekskluziv apo një agjent i vetëm - nga një zonë e cila ende nuk është e futur nën sistemin e ISMN-së, e si rrjedhim atij materiali nuk i është caktuar ndonjë ISMN. Në atë rast, shpërndarësi ekskluziv mund të caktojë një ISMN.
- b. kur një botimi të muzikës, i importuar nga disa shpërndarës (distributorë) nga një zonë e cila ende nuk është futur në sistemin e ISMN-së dhe të cilit, si rrjedhojë, nuk iu ka vënë asnjë ISMN. Në atë rast, ISMN-ja mund t'i vihet botimit nga agjencia kombëtare apo rajonale në të cilën janë anëtarë ata shpërndarës.

### **6. 12. Botuesit me më shumë se një vend të botimit**

Një botues, që vepron në disa vende që janë radhitur të gjitha së bashku në një botim duhet t'i vërë vetëm një ISMN njësisë së botuar.

Një botues, i cili udhëheq zyre të ndryshme apo degë në vende të ndryshme mund të ketë identifikues të ndryshëm botimi për secilën zyrë dhe degë. Megjithatë, secilës njësi duhet t'i vihet vetëm një ISMN: caktimi i saj bëhet nga zyra apo dega përgjegjëse për atë botim.

### **6. 13. ISMN të mos përdoret dy herë në kurrfarë rrethane**

ISMN-ja e caktuar njëherë, nuk mund të përdoret sërish. Kjo është gjëja më e rëndësishme që mundëson shmangien nga pështjellimi. Nëse një numër caktohet gabimisht, ai duhet të anulohet nga lista e numrave të cilët janë përdorur dhe nuk duhet t'i jepet ndonjë titulli tjetër. Botuesit kanë zakonisht numra të mjaftueshëm të identifikimit, kështu që humbja e një numri nuk paraqet ndonjë pengesë për ta.

Botuesit duhet ta njoftojnë agjencinë kombëtare apo rajonale për numrat e hequr, si dhe për njësitë të cilat ata numra iu kanë vënë gabimisht.

## **7. Shtypja dhe reklamimi i ISMN-së**

ISMN-ja duhet të shfaqet në vetë njësinë. Kjo është thelbësore për krejt sistemin e ISMN-së.

ISMN-ja duhet që gjithmonë të shtypet në një madhësi të mjaftueshme në mënyrë që leximi i saj të jetë i lehtë (mundësisht së paku në madhësinë 9).

## **7.1. Shtypja e ISMN-së në veprat muzikore**

### **7.1.1. Vendi ku duhet të shtypet ISMN-ja**

- ISMN-ja duhet të shtypet në pjesën e prapme të një partiture apo pjese.
- ISMN-ja, nëse praktikohet, duhet të shtypet, po ashtu, së bashku me vërejtjen për mbrojtjen autoriale.
- Nëse nuk është e mundur që ISMN-ja të shtypet në njërin nga këto pozicione, atëherë ajo duhet të shtypet në ndonjë pozicion tjetër të dallueshëm (p.sh., në fund të faqes së parë të materialit muzikor).
- Kur njësia të jetë një fletë e vetme, ISMN-ja duhet të shfaqet vetëm në një vend në njësi.
- Kur njësia të jetë antologji, ISMN-ja e antologjisë duhet të dallohet qartas prej ndonjë ISMN-je, e cila mund të jetë shtypur në ndonjë njësi të veçantë, e cila është e përfshirë në antologji.

### **7.1.2 Shtypja e të gjitha ISMN-ve të cilat i takojnë një botimi**

Këshillohet që të gjitha ISMN-të (të cilat iu kanë caktuar të gjitha pjesëve përbërëse të një botimi, dhe të ndjekura nga një emërtim i saktë) të shtypen së paku në njërin prej njësive. Nëse praktikohet, atëherë ISMN-të duhet të shtypen edhe në njërin apo më shumë njësi të tjera po ashtu.

*Shembuj:*\*

ISMN M-321-76543-6 (partiturë)

ISMN M-321-76544-3 (partiturë vokale)

ISMN M-321-76545-0 (komplet i pjesëve)

(\*Terminologjia e dhënë këtu, e emërtimeve identifikuese, është vetëm sa për ilustrim, dhe nuk është e vendosur me normë. Ato shkruhen në gjuhën e botimit.)

Kjo listë e ISMN-ve duhet të paraqitet së paku në partiturë, e preferohet që të vendoset edhe në partiturën vokale, e ndoshta edhe në secilën pjesë.

ISMN M-321-76546-7 (partiturë, e lidhur)

ISMN M-321-76547-4 (partiturë, e lidhur në kopertina të buta)

Lista e ISMN-ve duhet të dalë si në partiturën e lidhur ashtu edhe në atë me kopertina të buta.

Një botim shumëvëllimësh (shih kapitullin 6.5) duhet të trajtohet si më poshtë:

ISMN M-321-76548-1 (komplet)  
ISMN M-321-76549-8 (vëll. 1)  
ISMN M-321-76550-4 (vëll. 2)  
ISMN M-321-76551-0 (vëll. 3)

Lista e ISMN-vë duhet të dalë në të gjitha vëllimet; së paku ISMN-ja e kompletit e pastaj edhe ISMN-ja e secilit vëllim të caktuar duhet të dalë në secilin vëllim.

Nëse një komplet i pjesëve shitet apo shpërndahet në mbështjellës, atëherë ISMN-ja e kompletit duhet të shtypet në mbështjellës. Nëse pjesët shiten individualisht, atëherë ISMN-të e secilës pjesë individuale duhet të shtypen edhe në mbështjellës.

## **7.2 Shtypja e ISMN-së në kod të lexueshëm prej mjeteve kompjuterike**

Për shkak të OCR (Optical Character Recognition – Njohja Optike e Shifrave), ISMN-ja duhet të shtypet në formatin OCR-B.

Përhapja e shpejtë e barkodit dhe mënyra se si skanohet, mundëson përdorimin e barkodit 13-shifror që njihet ndërkombëtarisht. Të gjitha këto barkode fillojnë me identifikuesin kombëtar, përveç ato në libra dhe periodikë, si dhe ato të shtypura në materiale muzikore. Për shkak të rrjetit ndërkombëtar të tregtisë së librit, këto shifra 978 - për librin, 979 - për materialet e botuara muzikore dhe 977 - për periodikun, konsiderohen si shifra të “originës së librit” (bookland).

Prefiksi 979 pasohet nga ISMN-ja e plotë, duke e përfshirë edhe shifrën e kontrollit. “M”-së i caktohet vlera numerike zero (0) vetëm për barkod. Për llogaritjen e shifrës së kontrollit, prapëseprapë”, “M”-ja ka vlerën numerike 3 (shih kapitullin 2.1.4).

Shembull i shndërrimit të ISMN-së në kod “të originës së librit” (bookland)

ISMN	M -345-12345-8
M = 0	0345123458
Ia shtojmë edhe shifrën identifikuese të originës	9790345123458

Kjo është një ISMN e shndërruar në kod.

Më poshtë po japim se si duket në të shtypur ajo që u tha më lartë.



### **7. 3. Vënia e barkodit me 13 shifra. Udhëzime për prodhuesit etiketave të barkodeve**

Po qe se botuesit i marrin etiketat e barkodeve që të mund t'i shtypin pastaj ISMN-të në botimet e tyre, atëherë ata duhet t'i ndjekin procedurat e mëposhtme:

- Ta bëjnë valide ISMN-në, duke e përdorur shifrën e kontrollit të ISMN-së, e kjo për t'iu shmangur ndonjë gabimi në shkrim apo shtypje (shih algoritmin e shifrës kontrolluese të ISMN-së).
- Të gjenerohet kodi i “originës së librit” duke e shtuar 979 (shih kapitullin 7.2).
- Të shtypet si vijon:
  1. ISMN-në në shifra që mund t'i lexojë kompjuteri (OCR-B);
  2. ISMN në formë barkodi;
  3. ISMN-ja e shndërruar në barkod, të jetë në format që e njeh kompjuteri.

Të gjitha këto procedura duhet të kryhen përmes programeve kompjuterike. Po ashtu, duhet të kihet parasysh edhe kërkesat teknike të agjencisë ndërkombëtare të barkodit EAN.

Prapëseprapë, ISMN-të e shtypura në format e lexueshme nga kompjuteri u nënshtrohen rregullave të përpiluara në këtë doracak. Një numër i konsiderueshëm i rregullave shtesë dhe i rekomandimeve që na janë drejtuar, e bënë të nevojshëm që ata të cilët dëshirojnë t'i shtypin ISMN-të në madhësi të ndryshme që mund të skanohen, atëherë ata duhet të pyesin agjencinë e tyre kombëtare apo rajonale për këshilla, si dhe për emrat e prodhuesve të barkodeve në hapësirat ku veprojnë.

### **7. 4. Publikimi i ISMN-së**

ISMN-të duhet të botohen në reklamat e botuesve, në katalogët e tyre, listën e botimeve që kanë, pamfleteve e broshurave, si dhe në të gjitha materialet e tjera të botuara për qëllime marketingu.

Këshillohet që ISMN-të e shtypura në materiale të tilla të vendosen afër titullit dhe përshkrimit të njësisë.

Duhet të kihet parasysh se duhet të shtypet i tërë Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës, megjithatë shkronjat ISMN mund të mos shtypen po qe se elementet e tjera japin informacione të mjaftueshme se kemi të bëjmë me një Numër standard ndërkombëtar të muzikës.

## **8. Administrimi i sistemit të ISMN-së**

Administrimi i sistemit të ISMN-së bëhet në tri nivele: ndërkombëtar, kombëtar/rajonar, si dhe në atë të botuesit.

### **8. 1. Administrimi ndërkombëtar**

Administrimi ndërkombëtar i sistemit bëhet nga Agjencia Ndërkombëtare e ISMN-së, e cila e ka një Panel këshillues që e përfaqëson ISO dhe bashkësinë botuese dhe bibliotekare të muzikës (p.sh., Shoqata Ndërkombëtare e Bibliotekave, Arkivave dhe Qendrave Dokumentuese të Muzikës – International Association of Music Libraries, Archives and Documentation Centres).

Adresa e Agjencisë ndërkombëtare të ISMN-së, është:

International ISMN Agency  
Staatsbibliothek zu Berlin – Preussischer Kulturbesitz  
10772 Berlin (Germany)  
tel.: +49 30 266 2336 or 2498  
fax: +49 30 266 2378  
e-mail: [ismn@sbb.spk-berlin.de](mailto:ismn@sbb.spk-berlin.de)  
<http://ismn-international.org>

Funksionet kryesore të Agjencisë ndërkombëtare të ISMN-së janë:

- Të mbikëqyrë përdorimin e ISMN-së.
- Të miratojë definicionin dhe strukturën e agjencive kombëtare dhe rajonale.
- Të ndajë identifikues për agjencitë kombëtare dhe rajonale.
- Të këshillojë agjencitë kombëtare dhe rajonale në ndarjen e identifikuesve të botuesve.
- Të promovojë përdorimin e sistemit në mbarë botën.
- Të përzgjedhë një bord ndërkombëtar të ekspertëve që të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve.
- Të promovojë shkëmbimin e informacioneve përmes botimeve dhe takimeve rajonale.
- Të botojë një doracak udhëzues dhe ta freskojë vazhdimisht me informacione të reja.
- Të koordinojë aplikimin e ISMN-së si barkod.

Përveç këtyre, Agjencia ndërkombëtare ofron edhe këto shërbim:

- do të furnizojë agjencinë kombëtare ose rajonale me lista të ISMN-së (me shifra të kontrollit të gjeneruara përmes kompjuterit) që do të përdoren nga botuesit, të cilët veprojnë në territorin e asaj agjencie, ose do ta furnizojë edhe me program kompjuterik.
- do të sigurojë një udhëzues ndërkombëtar të botuesve të muzikës përmes informacioneve të mbledhura nga agjencitë kombëtare apo rajonale.
- do të sigurojë një listë të ISMN-ve të duplikuara apo jovalide në bazë të informacioneve të mbledhura nga agjencitë kombëtare apo rajonale.

## **8.2. Administrimi kombëtar apo rajonal**

Caktimi i identifikuesve të botuesit si dhe krijimi i lidhjeve mes botuesit dhe sistemit të ISMN-së bëhet përmes agjencisë kombëtare apo rajonale.

Këto agjenci emërohen prej Agjencisë ndërkombëtare të ISMN-së në bazë të një kontrate të lidhur.

Funksionet e një agjencie kombëtare apo rajonale janë:

- të mbajë kontakte me botuesit në shtetin apo rajonin ku vepron dhe t'i përfshijë botuesit e rinj në sistem;
- të mbajë lidhje me Agjencinë ndërkombëtare të ISMN-së në favor të të gjithë botuesve të shtetit apo rajonit ku vepron;
- të vendosë, në konsultim me organizatat tregtare dhe botuese, serinë e numrave identifikues të botuesve;
- të caktojë identifikuesit e botuesve për ata botues legjitim, të cilët mund t'i bashkëngjiten sistemit në atë shtet apo rajon dhe të mirëmbajnë një regjistër të këtyre botuesve dhe të identifikuesve të tyre;
- të vendosë, në konsultim me organizatat tregtare dhe botuese, se cili botues do t'i caktojë vetë numrat e ISMN-së për botimet e tyre, e cili botues do t'i marrë numrat për botimet e tyre nga agjencia kombëtare apo rajonale;
- të ofrojë këshilla dhe ndihmë teknike për botuesit dhe të sigurojë që janë respektuar standardet dhe procedurat e rregullta;
- të vërë në dispozicion një doracak udhëzues për botuesit në gjuhën e cila flitet në atë vend;
- të ofrojë listë të gatshme të ISMN-së të gjeneruar përmes kompjuterit, përfshirë edhe shifrën e kontrollit për botuesit të cilët u vënë botimeve të tyre;
- t'i bëjë valide të gjitha ISMN-të e caktuara nga botuesit, të cilët u vënë botimeve të tyre, si dhe të mbajë një regjistër të tyre;
- të informojnë botuesit për ndonjë ISMN dublikate apo jovalide;
- t'i caktojë ISMN-në të gjitha njësitë të atyre botuesve të cilët nuk vënë ISMN-në dhe të japin këshilla për caktimin e tyre;
- të arrijë që të vënë numrat e ISMN-së në të gjithë shtetin/rajonin ku veprojnë;

- të vëre lidhje me agjencitë bibliografike si dhe me ato që merren me botimin e listave të materialeve muzikore për shtypjen e ISMN-ve së bashku me titujt të cilat iu referohen;
- të ofrojë mundësi që botuesit t'u vënë ISMN edhe botimeve të mëhershme si dhe që të botohen ato në bibliografitë apo listat e caktuara tregtare;
- të ndihmojë sistemin tregtar në shfrytëzimin e ISMN-së në sistemin kompjuterik;
- ta furnizojë rregullisht Agjencinë ndërkombëtare të ISMN-së, dhe pa pagesë, me të dhëna të plota për prefikset dhe adresat e botuesve për futjen e tyre në udhëzuesin ndërkombëtar të botuesve të muzikës;
- ta informojë rregullisht Agjencinë ndërkombëtare të ISMN-së për aktivitetet e saj si dhe për gjendjen momentale të sistemit të ISMN-së në atë rajon;
- të kontribuojë financiarisht për mirëmbajtjen e Agjencisë ndërkombëtare të ISMN-së.

Adresa e Agjencisë kombëtare të ISMN-së, është:

Agjencia kombëtare e ISMN-së  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës  
Sheshi "Hasan Prishtina" p.n.  
10000 Prishtinë - Kosovë  
tel.: +381 38 212 458  
fax: +381 38 248 940  
e-mail: enimunishi@yahoo.com

## **9. ISMN-ja dhe numrat e tjerë standard ndërkombëtar**

### **9.1 ISBN-ja**

Disa prej botimeve të muzikës mund të shpërndahen përmes rrjetit tregtar të librit. Botuesit të cilët nxjerrin në botim materiale muzikore dhe të cilët kanë për qëllim t'i shpërndajnë apo shesin përmes rrjetit të librit, atëherë mund t'i shtojnë materialit një ISBN (Numrin Standard Ndërkombëtar të Librit) krahas ISMN-së.

Kjo e bën të vështirë nganjëherë që të përcaktohet nëse një botim (i tillë si libër këngësh, libër himnesh fetare, apo album me materiale të shtuara tekstuale apo ilustrative) është vepër muzikore, "libër normal", apo të dyja së bashku. Në këto raste, po ashtu, materialit mund t'i vihen ISMN-ja dhe ISBN-ja së bashku. Nëse botuesi dëshiron që ta vendosë vetëm njërin numër, atëherë zgjedhja i mbetet botuesit dhe ai ka të drejtë të vendosë se cilin prej tyre do ta përdorë, mirëpo ISMN-ja do të ishte numri më me vend të përdorej nëse ekziston dyshimi se cilin duhet përdorur.

Sistemi i ISBN-së administrohet nga Agjencia ndërkombëtare e ISBN-së, grupi i agjencive, dhe agjencitë kombëtare. Përdorimi i ISBN-së është i shtjelluar në një doracak tjetër.



Adresa e Agjencisë ndërkombëtare të ISBN-së, është:

International ISBN Agency  
Staatsbibliothek zu Berlin – Preussischer Kulturbesitz  
10772 Berlin  
Germany  
tel.: +49 30 266 2496 or 2338  
fax: +49 30 266 2378  
e-mail: isbn@sbb.spk-berlin.de  
<http://isbn-international.org>

Në rastin kur edhe ISMN-ja edhe ISBN-ja do të paraqiten në një botim, atëherë ato duhet të shtypen në atë mënyrë që të dallohen qartë prej njëra-tjetrës.

## **9.2. ISSN-ja**

Përveç ISMN-së dhe ISBN-së, ekziston edhe një sistem tjetër numërimi për botimet serike – Numri Standard Ndërkombëtar për Botimet Serike (ISSN – International Standard Serial Number).

Botime serike përcaktohen po ashtu çdo botim, pa marrë parasysh mediumin se si botohet, që del në pjesë të vazhdueshme (njëra pas tjetrës), dhe që shpesh mban një shënim shtesë në formë numerike apo kronologjike, dhe që ka për qëllim të vazhdojë për një periudhë të pacaktuar. (Botimet serike duhet të veçohen prej botimeve shumëvëllimëshe, të cilat janë të përcaktuara të botohen në një numër të caktuar të vëllimeve. Shih kapitullin 6.5.).

Botimet serike përfshijnë periodikët dhe seritë. Ka vetëm pak periodikë të muzikës së shtypur, mirëpo shumica e veprave muzikore dalin në seri. Te dy kategorive duhet t'u vihet ISSN-ja për secilin titull të botimit serik (e cila mbetet e njëjtë për të gjithë numrat e një periodiku apo të vëllimeve individuale të një serie) dhe një ISMN për secilën njësi individuale të serisë. (Nëse ndryshon titulli i serisë, atëherë duhet t'i vihet një ISSN e re.)

Sistemi i ISSN-së administrohet nga Sistemi ndërkombëtar i të dhënave të botimeve serike (ISDS – International Serials Data System), adresa e të cilit është:

ISSN International Centre  
20 Rue Bachaumont  
75002 Paris, France  
Tel.: (+33 1) 44882220  
Fax: (+33 1) 40263243  
E-mail: issnic@issn.org  
URL: <http://www.issn.org>

Botuesit e botimeve serike duhet të parashtrajnë kërkesë te Qendra ndërkombëtare e ISSN-së ose te Qendra e tyre kombëtare e ISSN-së, nëse ekziston një e tillë, për të marrë ISSN.

Botuesit nuk e caktojnë vetë ISSN-në. Atëherë kur edhe ISMN-ja edhe ISSN-ja paraqiten në një botim, ato duhet të shtypen në atë mënyrë që të dallohen qartë mes vete.

### **9.3. ISRC**

ISMN-ja nuk është krijuar për t'i numëruar incizimet me zë apo pamore (video) (përveç nëse ato janë pjesë e një materiali të shtypur muzikor; shih kapitullin 3). ISRC, Kodi Standard Ndërkombëtar i Incizimeve (International Standard Recording Code) numëron secilin incizim të një pjese (por shpesh jo edhe secilën njësi fizike), pa marrë parasysh kontekstin apo mbështjellësin në të cilin botohet. ISRC-ja administrohet nga IFPI (International Federation of Phonogram and Videogram Producers – Federata Ndërkombëtare e Prodhuesve të Fonogrameve dhe Videogrameve):

Adresa e Agjencisë së ISRC-së, është:

IFPI Secretariat  
54 Regent Street  
London SW1 5PJ, Great Britain  
Tel.: (+44 171) 8787900  
Fax: (+44 171) 8787950  
E-mail: [info@ifpi.org](mailto:info@ifpi.org)  
URL: [//www.ifpi.org](http://www.ifpi.org)